

BIBLIOTEKA

E

891.PP3-P3-32

L 94

GJIROKASTËR

SHTETIT



Andon lula

e Bileta
Cickut

TREGIME

873-883-32 -P3

L 9/3

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

S

ANDON LULA

BILETA E CIRKUT

(*Regime*)

~~56733~~ 1969

BIBLIOTEKA E SHETIT
GJIROKASTER

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

USHTARËT E VEGJËL

... Atë pasdite, Ariani ecte rrugës me nxitim. Ishte i shqetësuar. Mundohej t'u fshihej vështrimeve të udhëtarëve, sidomos të atyre që e njihnin. Pantallonat e lagura deri afër gjunjëve, edhe pse ishte munduar t'i shtrydhte, i pikonin ujë në asfaltin e vakët të mbrëmjes. Ecte dhe mendonte:

«Tani shokët do të tallen me mua, do të qeshin me të madhe, do të më thonë: ti dukesh si pulë e lagur».

... Ç'kishte ndodhur? Atë pasdite, nxënësit e klasës do të zhvillonin stërvitjen në repart. Komandanti u kishte thënë se do të stërviteshin në kalimin e pengesave, në brezin e kalitjes. Të gjithë ishin gëzuar. Ariani qëndronte pak më larg se shokët, nuk merrte pjesë në bisedat e tyre. Ai kishte tretur vështrimin nga dielli, që kishte filluar të ulej nga perëndimi.

«A do ta kaloj dot litarin»? — thoshte me vete Ariani dhe kujtonte ditën e kaluar të stërvitjes, kur shokët e kishin tallur, se ishte treguar frikacak në kalimin e tarabës.

«E pse të rrezikohem! Po sikur të rrëzohem dhe të vritem?! Pastaj, se mos jemi vërtet në luftë!»

Zëri i komandantit e përmendi.

— Kush do ta kalojë i pari litarin? — pyeti komandanti ushtarët e vegjël.

Ata heshtën. Vështruan komandantin e tyre në sy.

— Mirë atëhere, do ta kaloj unë një herë.

Komandanti vendosi të dy duart në litar, pastaj lëshoi trupin në ajër. Ai filloi të zvarritej aq shpejt, saqë pionierët, të çuditur, pëshpërisnin: «Sa shpejt që zvarritet!»

Komandanti kërceu nga litari në anën tjetër të bregut. Pionierët e duartrokitën duke thënë:

— Edhe ne do ta kalojmë!

Dhe të gjithë nxënësit e kaluan me radhë. I erdhi radha edhe Arianit. Ai vendosi të dy duart në litar dhe filloi zvarritjen. Bëri pak përpara, po pastaj të dy këmbët ju varën dhe ai ra në pellgun me ujë.

— U vrave? — e pyeti komandanti.

— Jo, shoku komandant!

— Herë tjetër duhet të stërvitesh më shumë.

* * *

— Vish pantallonat, Arian, se do të marrësh ndonjë të ftohtë.

— Ah, moj gjyshe! Jam shumë i mërzitur.

— Pse je i mërzitur të keqen gjyshja?

— Nuk e kalova dot litarin në brezin e kalitjes.

— E për këtë mërzitesh?! . .

— Të gjithë shokët e kaluan, kurse unë rashë në pellgun me ujë. U turpërova, gjyshe, turpërova shokët dhe komandantin.

— Mos u mërzit! Kur të shkosh ushtar, do t'i mësosh të gjitha. Tani je i vogël.

— I vogël?! Po shokët e mi, nuk janë në një moshë me mua? Pastaj, ne duhet të stërvitemi si ushtarë të vërtetë.

* * *

Të nesërmen nxënësit e klasës as që e vunë re Arianin në pushimin e madh. Ai ngjiti shkallët e katit të dytë të shkollës dhe, si u gjend në këndin e fletërrufeve, u ndal.

Një fletërrufe bënte fjalë për të. Iliri, shoiku i tij i klasës, e kritikonte ngaqë në stërvitje

nuk përpiqej si shokët në kalimin e pengesave. Arianit i erdhi inat, kafshoi buzët dhe përplasi me forcë njerën këmbë në çimenton e koridorit. Gjaku i kërceu në fytyrë e duart ju drodhën. «I poshtri, — belbëzoi nëpër dhëmbë Ariani. — Këtë as që e prisja. Më turpëroi në sy të gjithë shkollës. Më quan edhe frikacak! Hë. . . në më rëntë në dorë. . . ja tregoj unë atij».

Si tha kështu, përfshiu me një vështrim gjithë koridorin. Mendime të shumta i kaluan në kokë. Mendja i thoshte të bënte diçka me fletërrufenë. «Ajo nuk duhet të qëndrojë e varur në tabelë. Duhet ta heq, ta gris». Ky mendim i pëlqeu, po dhe e tronditi. E si ta griste fletërrufenë! Ç'do të ndodhte pastaj? Ç'do thoshin shokët? Sigurisht, ata do të zemëroheshin edhe më shumë, do ta kritikonin e s'ishte çudi që të merrnin ndonjë masë. «Në drejt të venë të gjitha. Unë jam nxënësi më i mirë i klasës e askush s'do të më bëjë gjë. Fundja, në klasë s'kam për të mbetur. Do të më kritikojnë ca, po, ama, Ilirit do t'i bjerë hunda në tokë. Do ta gris!»

Ariani zgjati dorën e në çastin kur dora e tij preku fletërrufenë, një zë pas tij e bëri të dridhej.

— Mos. . . Arian, s'të ka hije!

Tani që ishte ballë për ballë me Ilirin, aty për aty vendosi t'i tregonte vendin. I lëshoi ca

fjalë me thumba, po Ilirit dukej sikur nuk i bënëin përshtypje. Siç duket priste që Arianit t'i dilte inati e pastaj të kuvendonte me të urtë e butë.

Po Ariani ishte nxehur e bërë prush nga inati.

— Të njoh unë ty. Më ke inat, se jam i pari i klasës, ndaj dhe më kritikon. Po dëgjo këtu: hiqe vetë më mirë fletërrufenë, në mos po e heq me dorën time.

— Kjo nuk është sjellje prej pionieri. Dhe je nxënës i dhjetave. E ç'i duhen dhjetat e tua klasës, kur sillesh si kapadai? E dimë që je i pari në mësim, po mos u mburr, se ne të njohim.

— Po atëhere, pse e bërë fletërrufenë?

— Se tregohesh frikacak. Je djalë i përkëdhelur i gjyshes.

— Si the, qenkam djalë i përkëdhelur, qenkam dhe frikacak, ë? E kush guxon të më kritikojë, pa. . . ti! Shiko, hiqe, se ndryshe do. . .

— Ngadalë! Se nuk ta ka njeri frikën!

— Hiqe, se do të pëlcasë sherri, që të mbli-dhet gjithë shkolla.

— Ç'janë këto që thua, Arian, nuk të vjen turp?

— Hë. . . dashke dhe të më prekësh në se-dër. Më shet dhe mend!

— Mbaje gojën, ne jemi shokë e ti s'ke arësye të nxelesh. Mos nuk thashë të vërtetën? Ti gjithmonë i bën bisht stërvitjes ushtarake. Të kujtohet një javë më parë kur të erdha në shtëpi? Ti luaje në kopsht me lepujt, ndërsa gjyshja jote më tha: «Ariani është i sëmurë, nuk vjen dot në stërvitje». Ti bëre sikur nuk i dëgjove fjalët e gjyshes e vazhdove lojën. Hë. . . pse s'flet, apo s'të vjen mirë!

— Shiko, Ilir! Unë s'jam trazuar ndonjëherë në punët e tua! Ti ç'ke, pse ndërhyt në punët e mia? Pse i fut hundët atje ku s'duhet? Punë për mua se nuk vij në stërvitje! Pastaj ç'lidhje ka kjo ngjarje me fletërrufenë? .

— E shikon, akoma s'po të mbushet mendja. Jemi zotuar të zbatojmë pikë për pikë tre-këndëshin revolucionar mësim, punë prodhuese, kalitje fizike-ushtarake. Ti po bëhesh pengesë, për këtë duhet të mendohesh mirë. Unë kaq kisha. Tani, po deshe, hiqe fletërrufenë. Mir-upafshim!

Ariani fshiu me dorë ballin e mbuluar me djersë të ftohta. Hodhi një hap në koridor dhe nuk bëri më tutje. Qendroi. Ishte ballë për ballë me fletërrufenë. Ajo qëndronte ende e varur dhe atij i vinte shumë inat. Por, pas grindjes me Ilirin, kuptoi se ishte e kotë ta hiqte. Mendime të tjera i lindën në kokë. Mendoi mos t'i përgji-

gjej Ilirit me fletërrufe. «Nesër kemi marshim,
← tha me vete, — dhe. . .»

* * *

Kolona e ushtarëve të vegjël nisi marshimin drejt malit.

Komandanti shikonte herë pas here Arianin. Ai marshonte krah shokëve. Shiu i binte në fytyrë dhe këpucët i ngjiteshin në rrugët me baltë, por ai nuk donte t'ja dinte.

Po i afroreshin majës së malit dhe ushtarët e vegjël e ndjenin veten më të gëzuar. Era frynte si e tërbuar. Shiu u përplasej në fytyrë. Ja më në fund u ngjitën.

— Urra-a-a!



— Ky marshim ishte prova më e vështirë për ty, Arian. Tani s'ka nevojë t'i përgjigjesh fletërrufesë, — i tha Iliri.

— Faleminderit, Ilir. Unë edhe litarin do ta kaloj.

Të dy ushtarët e vegjël u futën në rresht. Komandanti i falënderoi ushtarët trima. Ata buçitën si ushtarë të vërtetë:

— I shërbejmë Republikës Popullore të Shqipërisë!